



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
NJËSIA E PROKURIMIT

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: **Furnizim vendosje e tabelave informuese (digjitale)**
KODI PÛRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **34992300-0 -
Tabela rrugore,**
VLERA E FONDIT LIMIT: **2,338,000 (Dy milion e treqind e tridhjetë e tetë mijë) lekë pa TVSH.**

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të Nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

1. Sipas kritereve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 8).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2023, 2024 dhe 2025) lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës e përkatësisht **935,200 (Nenteqind e tridhjetë e pese mijë e dyqind) lekë.**

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" "Ne lidhje me situaten ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën", "Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.", si dhe bazuar në nenin 43, pika 2/c, nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" "Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit "Shërbim konsulence".

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohe dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit dhe vendosja e këtij limiti nuk kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të ligjit Nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë

29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të ligjit Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar”: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata” si dhe Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 55, pika 4, ”Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës/lotit, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”. Referuar parashikimeve ligjore të nenit 43, pika 2, germa c), për procedurat nën kufirin e ulët monetar, siç është rasti i kësaj procedure.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për vitin 2025 (Sipas QKB) si dhe kështet e maturuara për vitin 2026 sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetdeklarimet në formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sic kërkohej në pikën 2.2.3, duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose kopje të njesuara me origjinalin.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për QKR” i ndryshuar.

Megjithatë operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit në një vlerë jo më të vogël se 20 % fondit limit në një vlerë prej **467,600 (katerqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind) lekë**, të ekzekutuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen:

- Për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga Enti Publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku të shënohen datat, shumat dhe **furnizimet** e realizuara.
- Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për përmbushjen e kriterit të përvojës së mëparshme është përcaktuar në përputhje me nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, si dhe me nenin 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ose, për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël/të thjeshtuar, në përputhje me nenin 55, pika 4, shkronja “b”, të së njëjtës VKM.

Ky kriter synon të verifikojë në mënyrë objektive nëse operatorët ekonomikë zotërojnë përvojën dhe kapacitetin profesional të nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi. Kërkesa për realizimin e furnizimeve/shërbimeve të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 20% e fondit limit është përcaktuar brenda kufirit të lejuar nga kuadri ligjor dhe nënligjor në fuqi dhe është në përpjesëtim me objektin, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Përcaktimi i këtij niveli **nuk** synon vendosjen e një barre të **pajustificuar** ndaj operatorëve ekonomikë, por përbën një mjet objektiv për të siguruar që operatori ekonomik fitues të ketë një eksperiencë të mëparshme të mjaftueshme dhe të verifikueshme në realizimin e kontratave me karakter dhe natyrë të ngjashme. Përvoja e mëparshme përbën një element të rëndësishëm për vlerësimin e aftësisë reale të operatorit ekonomik për të përmbushur detyrimet kontraktore brenda afateve, me cilësinë e kërkuar dhe në përputhje me specifikimet dhe kushtet e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

Në përcaktimin e vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është mbajtur në konsideratë edhe vlera e parashikuar e kontratës objekt procedure. Duke qenë se vlera e kontratës është nën kufirin e ulët monetar të zbatueshëm, kërkesa për realizimin e kontratave të ngjashme në vlerën 467,600 (katërqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind) lekë, që përfaqëson 20% të fondit limit, është vlerësuar si një nivel i arsyeshëm dhe i mjaftueshëm për të dëshmuar përvojën minimale të nevojshme të operatorit ekonomik.

Ky përcaktim është bërë duke respektuar parimet e proporcionalitetit, objektivitetit, trajtimit të barabartë dhe nxitjes së konkurrencës, pasi kërkesa lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe nuk tejkalon nivelin e nevojshëm për të garantuar aftësinë e operatorit ekonomik për realizimin e

saj. Në këtë kuptim, kërkesa prej 20% nuk përbën një kriter të tepruar apo kufizues të konkurrencës, por një kërkesë minimale dhe proporcionale, e cila synon të balancojë nevojën e Autoritetit Kontraktor për të garantuar realizimin e suksesshëm të kontratës me detyrimin për të ruajtur konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Në këto kushte, kriteri i vendosur është i lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës, është i arsyeshëm, objektiv dhe proporcional me qëllimin që kërkohet të arrihet dhe, duke qenë i përcaktuar në masën 20% të fondit limit dhe brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, nuk krijon një kufizim të pajustificuar të konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë. Përkundrazi, ai shërben si një mekanizëm i nevojshëm për të garantuar që kontrata të realizohet në mënyrë të rregullt, brenda afateve dhe me standardin e kërkuar të cilësisë, duke mbrojtur njëkohësisht interesin publik dhe interesin e ligjshëm të Autoritetit Kontraktor.

2.3.2 Operatori ekonomik nëse nuk është prodhues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar për shitje për *Ekranin 65" touch screen dhe kameran*, ku të përcaktohen edhe kontaktet e prodhuesit ose të distributorit të autorizuar (emër, e mail). Në rast se do të paraqitet autorizim nga Distributori i Autorizuar duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 8, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Në këtë kontekst, është domosdoshmërisht në dobi të përfituesve finale dhe produkteve/shërbimeve më cilësore, pra garanci për zbatimin me rigorozytet të furnizimit të mallit. Në këtë mënyrë provohet dhe aftësia reale e operatorit ekonomik për të realizuar kontratën në cilësi, sasi e kohë. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale etj., reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë ose broshura me të dhënat teknike për ekranin 65” touch screen dhe kameran që oferton. Në katalog, të markohet në menyre të qartë dhe të dallueshme specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DST. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të hartës digjitale që është objekt i prokurimit me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike të markës dhe modelit të ofertuar do të krahasohen me specifikimet teknike të DST për përputhshmerine e tyre.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pikën 8, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar për mallrat e furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion përkatës. Katalogu është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, garanton se cilësinë e këtyre mallrave.

2.3.4 Operatori ekonomik për të garantuar realizimin e shërbimit duhet të disponojë ose të angazhojë kapacitete dhe staf të kualifikuar për zbatimin e kontratës, si më poshtë:

1. Specialist GIS (1 person)

Kualifikimet minimale:

- Diplomë universitare në Gjeografi, GIS, Gjeoinformatikë ose fusha të ngjashme.
- Kontratë individuale pune (e vlefshme);
- Librezë pune/deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton ekspseriencën në projekte të hartëzimit dixhital, jo më pak se 1 vit.

2. Ekspert Turizmi (1 person)

Kualifikimet minimale:

- Diplomë universitare në Turizëm, Menaxhim Turizmi ose fusha të ngjashme.
- Kontratë individuale pune (e vlefshme);
- Librezë pune/deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton ekspseriencën në projekte të marketingut ose promovimit turistik, jo më pak se 1 vite.

3. Ekspert IT / Zhvillues Software (2 persona)

Kualifikimet minimale:

- Diplomë universitare në Informatikë, Inxhinieri Software ose fusha të ngjashme. Njohuri në JavaScript, PHP, Python ose teknologji ekuivalente.
- Kontratë individuale pune (e vlefshme);
- Librezë pune/deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e –albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton ekspseriencën menaxhimin e bazave të të dhënave PostgreSQL/PostGIS, MySQL ose ekuivalente, jo më pak se 1 vite përvojë në zhvillim aplikacionesh web.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetdeklarimet në formularin përmbledhës të vetdeklarimit, siç kërkohet në pikën 2.3.4, duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose kopje te njesuara me origjinalin.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 4, i Ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar, lejon kërkesa për kapacitetet teknike dhe profesionale të nevojshme për zbatimin e kontratës, nenin 41, pika 4, shkronjat “b” dhe “c”, i VKM nr. 285/2021, e ndryshuar,

Specialist GIS (1 person)

Detyrat kryesore:

- Mbledhja, përpunimi dhe organizimi i të dhënave gjeohapësinore.
- Krijimi dhe menaxhimi i shtresave GIS (atraksione turistike, shtigje, monumente, akomodim, transport etj.).
- Integrimi i të dhënave GIS në platformën dixhitale.
- Kontrolli i cilësisë dhe saktësisë së koordinatave dhe hartave.
- Përgatitja e metadata-ve dhe dokumentacionit teknik.

2. Ekspert Turizmi (1 person)

Detyrat kryesore:

- Identifikimi dhe klasifikimi i atraksioneve turistike, produkteve turistike dhe itinerareve.
- Përgatitja e përmbajtjes informative për pikat e interesit.
- Verifikimi i saktësisë së informacionit turistik.

- Bashkëpunimi me operatorët turistikë dhe institucionet lokale.
- Mbështetja e promovimit të destinacionit përmes platformës.

3. Ekspert IT / Zhvillues Software (2 persona)

Detyrat kryesore:

- Projektimi dhe zhvillimi i platformës WebGIS dhe aplikacionit multimedial.
- Krijimi i bazës së të dhënave dhe integrimi me sistemin GIS.
- Zhvillimi i ndërfaqes së përdoruesit (web dhe mobile responsive).
- Integrimi i fotove, videove, materialeve audio dhe përmbajtjeve multimediale.
- Testimi, optimizimi dhe mirëmbajtja e sistemit.
- Sigurimi i mbrojtjes së të dhënave dhe performancës së platformës

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm i cili është ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike në përputhje me nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialistët anëtarë të njësisë së prokurimit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.